

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit
Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”
Universiteti i New York-ut në Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Mira Mezini

Prof.Asoc. Elinda Kajo Meçe

Dhjetor 2018



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"

Universiteti i New York-ut në Tiranë

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i New York-ut në Tiranë
2	Fakulteti që e ofron/Departamenti përgjegjës	Fakulteti i Informatikës/ Departamenti i Shkencave Kompjuterike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 939, datë 03.09.2009 Leja e aktivitetit UMASH Nr. 203, datë 06.05.2011*)
4	VKA /Urdhëri i Akreditimit të parë	VKA Nr. 323, datë 16.03.2012 (Pozitiv, me rekomandime) UMASH Nr. 170, datë 20.04.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Shkenca Kompjuterike"
6	Cikli i studimit:	Cikli II
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
11	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	-
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Në VKM Nr. 939, datë 03.09.2009 shkruhet se programi ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Grenëinch-it, Britani e Madhe
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Diplomë e dyfishtë
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Aktivizimi i programit të studimit	Në vitin 2011
17	Numri i studentëve	Viti 2016-2017 18 studentë Viti 2017-2018 9 studentë Viti 2018-2019 12 studentë

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

*) Me shkresë Nr. 6858/2 prot, datë 06.05.2011, MASH konfirmon marrjen e njoftimit për përshtatjen që IAL i ka bërë programit të studimit, në program studimi i ciklit të dytë, "Master Shkencor" në "Shkenca Kompjuterike", që realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vjet.

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike

(Të dhëna zyrtare për hapjen e programit të studimit, miratimin e hapjes, akreditimin e parë, etj.)

Programi i Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike ofrohet nga Universiteti i New York në Tiranë në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich, Londër, Mbretëria e Bashkuar. Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike është licencuar me Vendim Nr.939, datë 03.09.2009 të Këshillit të Ministrave si "Diplomë e Nivelit të Dytë" dhe është akredituar me Urdhër të MASH Nr. 170, datë 20.04.2012.

Në vitin 2009, UNYT ka institucionalizuar partneritetin me Universitetin e Greenwich (UoG) për ofrimin e një diplome të përbashkët në Shkenca Kompjuterike. Sipas Marrëveshjes [dok "Memorandumi i Marrëveshjes ndërmjet UoG dhe UNYT"], bashkëpunimi me Universitetin e Greenwich-it do të jetë deri më 31 tetor 2019, ku UNYT është përgjegjës për implementimin dhe realizimin e programit të studimit në përputhje me të gjitha kërkesat lidhur me logjistikën, infrastrukturën dhe procesin e mësimdhënies, ndërsa UoG është përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e programit.

Programi i studimit ofron një diplomë të dyfishtë nga të dy universitetet, ku studentët pajisen me dy diploma, një nga UNYT dhe një nga UoG. Studenti mund të zgjedh të regjistrohet edhe vetëm për diplomë të ofruar nga Universiteti i New York-ut në Tiranë, pa ju nënshtruar procedurave në bashkëpunim me UoG.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Prof. Mira Mezini

Prof.Asoc. Elinda Kajo Meçe

Koordinatorë teknikë të procedurës së vlerësimit janë specialistët e ASCAL, R. Qatipi dhe E. Xharo.

Më datë 02.12.2018 Universiteti i New York-ut në Tiranë është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për këtë program studimi, nëpërmjet sistemit AMS. Me shkresë Nr. 39/19 Prot., datë 03.12.2018 "Dërgohet Draft Raporti i vlerësimit të jashtëm", Draft RVJ është dërguar zyrtarisht.

Universiteti i New York-ut në Tiranë ka sjellë përgjigje me shkresë Nr. 360, datë 04.12.2018 "Kthim përgjigje mbi draft raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit "Msc. Shkenca Kompjuterike", [cit:]

"Shprehim falenderimet tona institucionale lidhur me objektivitetin e raportit për programin e studimit MSH në Shkenca Kompjuterike dhe konstatimet e rekomandimet me vlerë. Në lidhje me komentin për rekomandimin b) të lënë nga akreditimi i mëparshëm: "Deri pak para vizitës në Institucion, dy anëtarë të stafit që janë paraqitur në dokumentet e dorëzuara kishin dhënë dorëheqjen", dëshirojmë t'ju informojmë se UNYT ka punësuar me kohë të plotë, duke nisur nga data 26.11.2018, personelin akademik në Departamentin e Shkencave Kompjuterike, si më poshtë: Dr. Festim Halili; Prof. Dr. Andrej Stefanov".

Ekspertët e vlerësimit mendojnë se UNYT bën përpjekje serioze për punësimin e stafit akademik të kualifikuar. Megjithatë GVJ mendon se mbajtja e numrit minimal të plotësimit të kritereve (7 pedagogë për çdo njësi bazë) do të sjellë vështirësi sa herë që do të ketë lëvizje të stafit akademik. Vlerësimi përfundimtar i plotësimit të rekomandimit b) bëhet përmesht **kryesisht**.

REKOMANDIMET NGA AKREDITIMI I PARË

- a) Të përmirësohet cilësia e studentëve të pranuar në këtë program studimi.
- b) Të shtohet numri i personelit akademik me kohë të plotë.
- c) Të ndërtohet një kampus për studentët pasi në këtë mënyrë UNYT ka mundësi të ketë valencë kombëtare apo edhe rajonale (Ballkanike).

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

- a. Për rekomandimin a) institucioni ka vendosur kriteret për të regjistruar në program vetëm studentë që kanë një nivel të Gjuhës Angleze së paku B1 dhe me mesatare të notës prej 6.5. Për studentët me formim jo të plotë në informatikë ose me vështirësi në disa lëndë specifike, institucioni ka ristrukturuar programin parapërgatitor, duke e ofruar programin në një periudhë intensive për forcimin e aftësive të studentëve në C++, në Java, inxhinieri software në Java dhe UML, bazat e të dhënave dhe SQL. Struktura e re e programit parapërgatitor ka përmirësuar cilësinë e studentëve të regjistruar. Në rast se nuk plotësohet kriteri i mesatares ngrihen komisione për të vlerësuar cilësinë e studentit dhe kapacitetin për të ndjekur programin parapërgatitor.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- b. Për rekomandimin b), institucioni që nga koha e akreditimit të fundit të programit, viti 2012, UNYT ka bërë përpjekje serioze për punësimin e një stafi akademik të kualifikuar si personel akademik efektiv. Megjithatë punësimi i një stafi akademik të kualifikuar në fushën e programit të studimit nën vlerësim mbetet një sfidë për institucionin. Deri pak para vizitës në Institucion, dy anëtarë të stafit që janë paraqitur në dokumentet e dorëzuara kishin dhënë dorëheqjen. GVJ mendon se mbajtja e numrit minimal të plotësimit të kriterëve (7 pedagogë për çdo njësi bazë) do të sjellë vështirësi sa herë që do të ketë lëvizje të stafit akademik.

Rekomandimi është përmbushur kryesisht

- c. Për rekomandimin c) institucioni ka marrë masa që në tetor 2014 dhe është zhvendosur në një kampus të ri me hapësira më të mëdha, pajisje më moderne dhe infrastrukturë më të mirë në përgjithësi.

Rekomandimi është përmbushur plotësisht

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Bazuar në RVB [faqe10] dhe dokumentacionin e paraqitur nga UNYT, qëllimet themelore të Programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike” janë si më poshtë:

- Përgatitja e specialistëve dhe kërkuesve në fushën e informatikës që do të jenë liderë të ardhshëm në departamentet e tyre përkatëse në industri apo akademi.
- Eksplorimi i tendencave aktuale në të cilat industria e TI dhe Shkencave Kompjuterike në tërësi po zhvillohen si dhe pajisja e studenteve me arsimin e nevojshëm për të zotëruar dhe zhvilluar këto tendenca.
- Plotësimi i boshllëqeve aktuale në industrinë e TI në Shqipëri me specialistë në fushat më të kërkuara, si Rrjetat kompjuterike, Inxhinieria e Softuerit, Siguria dhe Menaxhimi i Bazave të të dhënave.

Objektivat e programit të Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Kompjuterike”, [RVB fq10] paraqiten më poshtë :

- Përgatitja e studentëve që vijnë nga disiplina të ndryshme nga (por të lidhur me) Shkencat Kompjuterike me themelet e nevojshme në mënyrë që ata të mund të ndjekin studimet pasuniversitare.
- Sigurimi i studentëve me mjetet, njohuritë baze dhe të detajuara sipas nevojës për të ndihmuar në studimet e mëtejshme të doktoraturës në Shkencat Kompjuterike.
- Edukimi i studentëve me mjetet, konceptet dhe metodologjitë e nevojshme për kërkim shkencor të pavarur. Udhëzimi nëpër të gjitha fazat e ndryshme të procesit.
- Trajnimi i studentëve në mënyrë që ata të jenë në gjendje të analizojnë, zhvillojnë dhe mirëmbajnë sisteme komplekse kompjuterike.
- Trajnimi i studentëve me praktika të orientuara drejt certifikatave profesionale që do të jenë të dobishme për karrierën e tyre të ardhshme në industri.

Programi i Studimit Master i Shkencave në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me qëllimin dhe misionin e UNYT të përcaktura në dokumentin e statutit [dok "Statuti i UNYT"].

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me qëllimin dhe misionin e UNYT [dok "Statuti i UNYT"]. Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është hartuar duke patur parasysh nevojat e tregut për profesionistë në fushën e programit, inxhinierisë
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	

<p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>se softit, bazave të të dhënave dhe rrjetat të kompjuterave.</p> <p>Drejtuesit e programit kanë zhvilluar disa anketime gjatë viteve në mënyrë që analiza e tregut të përdoret si bazë për zhvillimin e programit të Studimit. MSc në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe interesin kombëtar. [ref. Takimi me dekanin dhe shefin e departamentit]</p> <p>[dok "Anketim për Përmirësimin e Programit Parapërgatitor"]</p> <p>[dok" Anketim i ish-Studentëve"]</p> <p>[dok" Anketim për Punëdhënësit"]</p>
<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programet e studimit të ofruara në UNYT janë në përputhje me qëllimin, misionin dhe strategjinë e zhvillimit institucional. Plani mësimor i programit të studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është hartuar në përputhje me misionin e UNYT, në kontekst lokal dhe nderkombëtar. [dok" Plani Strategjik i UNYT 2017-2022"], [dok" Strategjia e Zhvillimit të Programit"]</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit, është në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.</p> <p>Studenti i diplomuar në këtë program studimi ka mundësi që të punësohet si profesionist në tregun vendas përmes ekspertizës së fituar në inxhinierine software, bazen e të dhënave dhe rrjetat kompjuterike. [dok "Dokumenti i Programit"], [dok "Memorandumi i Marrëveshjes UoG-UNYT"].</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>UNYT ka hartuar një plan strategjik për periudhën kohore 2018-2022.</p> <p>Institucioni është në një periudhë ndryshimesh për shkak të ndryshimit të pronësisë.</p> <p>[Takimi me drejtuesit e programit të studimit, dekani dhe shefi i departamentit]</p> <p>[dok" Plani Strategjik 2018-2022].</p> <p>[dok" Strategjia e Zhvillimit të Programit].</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është në përputhje me qëllimet, misionin dhe strategjinë e zhvillimit të UNYT. Objektivat e programit të studimit përcaktojnë qartë dijet, aftësitë dhe</p>	

kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit. Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është hartuar duke patur parasysh nevojat e tregut për profesionistë në këtë fushë dhe duke ndjekur strategjitë e zhvillimit të UNYT.

Pranimi i studentëve me disa mangësi të formimit të mëparshëm bazë në fushën e informatikës, bën vazhdimisht të nevojshëm ofrimin e programit parapërgatitor.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Universiteti i UNYT është i përbërë nga 3 njësi kryesore Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Shoqërore, dhe Fakulteti i Informatikës [dok “ urdhëri MASR, Nr. 288, datë 22.05.2017”]. Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike i cili është pjesë e Fakultetit të Informatikës.

Fakulteti i Informatikës, i krijuar në vitin 2017, përbëhet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike [dok “Organigrama e universitetit sipas statutit të vitit 2017”]. Para riorganizimit Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka qënë pjesë e Fakultetit të Drejtësisë, Artit dhe Shkencave.

Fakulteti i Informatikës dhe Departamenti i Shkencave Kompjuterike organizojnë dhe drejtojnë mësimdhënien në programin e studimit MSc në Shkenca Kompjuterike. Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka shtatë anëtarë, nga të cilët tre janë me titull Doktor. Dy departamentet, Shkenca Kompjuterike dhe Informatika e Biznesit, ofrojnë programe studimi Bachelor dhe Master.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike koordinon mësimdhënien me njësitë e tjera, në veçanti me departamentet e Fakultetit të Informatikës përmes shkëmbimit të stafit dhe përdorimit të përbashkët të infrastrukturës. Personeli akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, si dhe personeli akademik i ftuar. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në Kontratën e Punës. Fakulteti i Informatikës në vitin akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 21 personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 me kontratë (PAK) [Tabela 1, 2].

Gjatë vizitës në institucion, në takim me drejtuesit e fakultetit dhe departamenti u deklarua se, dy prej stafit akademik me tituj, Prof. dhe Dr., sapo kishin dhënë dorëheqjen, në këto kushte institucioni do të marrë masa për nisjen e procedurave të punësimit për vendet e krijuar bosh. Largimi i tyre reduktonte në 6 anëtarë numrin e anëtarëve të Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike.

Numri i personelit akademik me kohë të plotë në Departamentin e Shkencave Kompjuterike është 7, gjithësesi GVJ mendon se këto përpjekje duhet të jenë të vazhdueshme për të siguruar jo vetëm procesin e mësimdhënies por edhe atë të kërkimit shkencor. Departamenti i Shkencave Kompjuterike koordinohet edhe me njësi të tjera administrative dhe akademike për të bërë të mundur ofrimin e programit Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike, si Zyra e Programeve Master, Departamenti i TI-së, zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Ceshtjeve Operacionale.

Këshilli shkencor i programit të Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike [referuar RVB fq20] është në Tabelën 3 në aneks.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit

Referuar dokumentit "Organigrama e universitetit sipas statutit të vitit 2017"

Fakulteti i Informatikës është krijuar në vitin 2017, përbëhet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Departamenti i Informatikës Ekonomike dhe Qendra për Kërkime të Avancuara Kompjuterike

- Të dhëna për Stafin akademik

Tabelat 1, 2 paraqesin personelin akademik (PAE dhe PAK) sipas njërive bazë të Fakultetit që ofron programin e studimit MSc në Shkenca Kompjuterike. Në këto tabela reflektohen edhe ndryshimet ndër vite akademike në emërtimin dhe strukturën e Fakultetit.

Viti akademik 2012-2013 jane 8 PAE/15 PAK

Viti akademik 2013-2014 jane 8 PAE/15 PAK

Viti akademik 2014-2015 jane 9 PAE/8 PAK

Viti akademik 2015-2016 jane 7 PAE/7 PAK

Viti akademik 2016-2017 jane 7 PAE/4 PAK

Viti akademik 2017-2018 jane 7 PAE/0 PAK

Nga të dhënat evidentohen ndryshime në raportet PAE/PAK në favor të PAE nga viti akademik 2012-2013 (8/15) në 7/0 në vitin akademik 2017-2018, Po ashtu vihet re që në tre vitet e fundit numri i PAE të Departamentit të Shkencave Kompjuterike ngelet konstante prej 7 PAE (7 anëtarë sipas ligjit për ekzistencën e njësisë bazë).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	<p>UNYT është organizuar sipas një strukture që ndihmon në përmbushjen e misionit të tij. [dok "Organigrama e universitetit sipas statutit të vitit 2017"].</p> <p>UNYT ka tre fakultete në kuadër të riorganizimit të miratuar në 2017. Fakulteti i Informatikës është njëri prej tre Fakulteteve. Fakulteti i Informatikës ka tre njësi, Departamentin e Shkencave Kompjuterike, Departamentin e Informatikës së Biznesit dhe Qendra për Kërkime të Avancuara në Informatikë.</p> <p>Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike që po i nënshtrohet riakreditimit, ofrohet si pjesë e Fakultetit të Informatikës. Departamentin e Shkencave Kompjuterike.</p> <p>Cdo njësi në Fakultetin e Informatikës ka në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët 3 janë me gradën shkencore "Doktor". [dok "Përbërja e stafit akademik. Stafit akademik Përbërja 2018-2019].</p> <p>GVJ rekomandon se institucioni duhet të bëjë përpjekje të</p>
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".	


	vazhdueshme në konsolidimin e stafit akademik, mbajtja e numrit minimal të plotësisimit të kritereve (numri 7 për njësi bazë), do të sjellë vështirësi sa herë që do të ketë lëvizje të stafit akademik.
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamentet janë të angazhuara në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e programeve të studimit. Departamenti i Shkencave Kompjuterike siguron zbatimin e programit të studimit në bashkëpunim me dy departamentet e tjera. Departamenti i Shkencave Kompjuterike e ka hartuar programin e studimit në përputhje me zhvillimet e fundit si dhe me kërkesat të tregut të punës, duke iu nënshtruar proceseve vetëvlerësuese, procedurave të vlerësimit nga universiteti partner. [dok “ Propozimi i Departamentit për themelimin e Fakultetit të ri të Informatikës”].</p> <p>Fakultetet dhe departamentet përfshihen në procesin e rekrutimit të stafit nëpërmjet komisioneve të posaçme të formuar për çdo proces punësimi.</p> <p>[dok “ Politika për punësimin e fakultetit”].</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>UNYT ka organizimin e duhur strukturor për përmbushjen e misionit të tij. Është i organizuar sipas ligjit të arsimit të lartë dhe të gjitha njësitë përkatëse janë të përfshira në realizimin e programit të studimit. Rekrutimi i stafit akademik është transparent. Fakultetet dhe departamentet përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>GVJ rekomandon se janë të nevojshme përpjekje të vazhdueshme në drejtim të rritjes dhe konsolidimit të stafit akademik, për të siguruar jo vetëm mësimdhënien por edhe kërkimin shkencor.</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Për realizimin e programit të Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike janë angazhuar personel akademik, i cili përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë (PAE) si dhe personel akademik me kontratë me kohë të pjeshme (PAK) si dhe staf ndihmës mësimor-shkencor. UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit akademik [dok “Faculty Selection Criteria and Procedures”]. Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës [dok “Shembuj Kontrate të Stafit Akademik”]. Institucioni ka bërë përpjekje konkrete për shtimin e stafit akademik me kohë të plotë, që nga akreditimi i




parë. Në programin MSc në Shkenca Kompjuterike janë të angazhuar në mësimdhënie gjashtë antarë staf akademik me titull doktor dhe dy asistentë pedagogë me titull MSc (njëri prej tyre është kandidat Ph.D.) Nga këta tetë anëtarë personel akademik efektiv, njëri mban titullin Profesor dhe një është Profesor i Asociuar në Shkencat Kompjuterike.

Përveç anëtarëve të fakultetit, UNYT ka angazhuar edhe gjashtë pedagogë me kohë të pjesshme, të gjithë me titull doktor, njëri prej tyre mban titullin Profesor. Nga gjashtë pedagogë me kohë të pjesshme, tre prej tyre vijnë nga Italia, një nga Maqedonia dhe dy jetojnë dhe punojnë në Shqipëri. Gjatë vizitës në institucion, në zyrën e burimeve njerëzore u kontrolluan në mënyrë rastësore një dosje të stafit akademik të brendshëm dhe dy dosje të stafit akademik të jashtëm. Dosjet e stafit akademik u përzgjodhen rastesisht. Dosjet përmbanin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Në programin MSc në Shkenca Kompjuterike janë të angazhuar në mësimdhënie gjashtë antarë staf akademik me titull doktor dhe dy asistentë pedagogë me diplome MSc (njëri prej tyre është kandidat Ph.D.) Nga këta tetë anëtarë personel akademik efektiv, njëri mban titullin Profesor dhe një është Profesor i Asociuar në Shkencat Kompjuterike.

Përveç anëtarëve të fakultetit, UNYT ka angazhuar edhe gjashtë pedagogë me kohë të pjesshme, të gjithë me titull doktor, njëri prej tyre mban titullin Profesor. Takimi me stafin akademik u zhvillua sipas agendës, në datën 26.10.2018. I gjithë takimi u organizua mbi bazën e pyetjeve dhe diskutimeve rreth metodave të mësimdhënies, mënyrës së vlerësimit të studenteve, mënyrës së rekrutimit të tyre si dhe procedurave të vlerësimit dhe të sigurimit të cilësisë nëpërmjet Universitetit partner të Greenwich-it.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), të angazhuar në programin e studimit MSc në Shkenca Kompjuterike, paraqiten në tabelën 4

Viti Akademik 2012 – 2013 raporti PAE/PAK është 4/7	(36%/64%)
Viti Akademik 2013 – 2014 raporti PAE/PAK është 5/6	(45%/55%)
Viti Akademik 2014 – 2015 raporti PAE/PAK është 6/7	(46%/54%)
Viti Akademik 2015 – 2016 raporti PAE/PAK është 5/4	(55%/45%)
Viti Akademik 2016 – 2017 raporti PAE/PAK është 6/6	(50%/50%)
Viti Akademik 2017 – 2018 raporti PAE/PAK është 8/6	(57%/43%)
Viti Akademik 2018 – 2019 raporti PAE/PAK është 7/6	(53%/47%)

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabela 5)

Nga të dhënat vihet re një ndryshim në numër dhe në kualifikim të stafit akademik PAE, të angazhuar për programin e studimit. Në vitin akademik 2012-2013, janë 4 PAE ku 1 Prof.Asoc. dhe 3 PhD, ndërsa në vitin akademik 2017-2018 janë 8 PAE, ku 1 Prof, 1 Prof.Asoc, dhe 3 PhD.

Të dhëna sipas moshës së personelit .

Të paraqitura në Tabela 6. Nga të dhënat evidentohet se më shumë se gjysma e PAE janë në moshat 36-45 vjeç

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

I gjithë personeli akademik efektiv në UNYT është i pajisur me kontrata të rregullta punësimi në përputhje me kodin e punës të Republikës së Shqipërisë. Departamenti i Burimeve Njerëzore, është zyra e mbajtjes së kontratave të punës dhe dosjeve të punësimit.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

UNYT angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë . Numri 7 i stafit akademik ndihmës është në përputhje me nevojat e programit të studimit master.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Stafi akademik për programin e studimit MSc në Shkenca Kompjuterike Viti akademik 2018 – 2019.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit Msc në Shkenca Kompjuterike është i angazhuar në përputhje me objektivat e programit dhe në realizimin e programit në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it, Londër, Mbretëria e Bashkuar. [dok” Shembull i raportit vjetor të paraqitur në Universitetin e Greenwichit.”].</p> <p>Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit MSc në Shkenca Kompjuterike angazhohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit. [dok” Plani Strategjik i UNYT dhe Strategjia e Zhvillimit të Programit.”]</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Stafi akademik është i angazhuar në rishikimet periodike të kurrikulave dhe në vendimet institucionale. Zhvillimi dhe rishikimi i kurrikulave kryhet në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it. [dok” Dokumenti i Programit, Seksioni mbi Mbështetjen Akademike”]. Rishikimi i kurrikulës merr parasysh mendimet nga Kompanite ku punesohen studentet dhe të dhënat statistikore të punësimit. [dok”, Anketim për Përmirësimin e Programit Parapërgatitor”] [dok” Anketim i ish-Studentëve”].</p> <p>Rekrutimi i stafit akademik dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore të tyre është transparente dhe në përputhje me ligjet dhe ligjet në fuqi. [Dok” Politika për punësimin e personelit akademik.”]</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;

Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

UNYT ka procedura transparente dhe të qarta për rekrutimin e personelit akademik.

Në Zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden të dhëna të hollësishme për anëtarët e personelit akademik, ndihmës, dhe administrative. Ka një listë të plotë të personelit akademik me lëndët përkatëse sipas semestrave.

Më shumë se 70% e lëndëve realizohen nga stafi akademik efektiv. [dok" Lista e kurseve për lektorë me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme ne MSc ne Shkenca Kompjuterike"] Nga ky dokument, që tregon situatën para vizitës evidentohet se në programin parapërgatitor e gjithë ngarkesa mbulohet nga PAE. Ndërsa referuar tabelës 13 në aneks, për vitin akademik 2018-2019 ngarkesa e programit parapërgatitor mbulohet nga 2 PAE dhe 2 PAK.

Referuar tabelës 13 në aneks, evidentohet se nga 19 lëndë, ku përfshihen 7 lëndë bazë dhe nga 4 lëndë në tre grupet e lëndëve të specializuara, 14 lëndë mbulohen me PAE dhe 5 lëndë mbulohen me PAK. 73 % e ngarkesës mbulohet me PAE.

Referuar Tabeles 13 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës, evidentohet se mbi 70 % e ngrakesës mbulohet nga PAE, por gjithashtu vihet re se një Prof.Asoc mbulon 7 lëndë nga të cilat 5 të plota dhe dy të ndara me kolegë. Po ashtu një pedagog me PhD mbulon 5 lëndë, ku 4 janë të plota dhe një e ndarë me kolegë.

Në keto kushte ngelet një çështje e hapur ngarkesa e stafit akademik efektiv.

UNYT zbaton procedura transparente për vlerësimin e stafit. Vlerësimi kryhet nga studentët e programit të studimit dhe nga pedagogët e departamentit. [dok" Modeli i vlerësimit të kursit nga studentët e MSc."], [dok" Vlerësimi individual vjetor i performances"], [dok" Formulari i vlerësimit të profesorëve nga kolegët"], [dok" Sistemi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore në Fakultetin e Informatikës"].

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;

Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";

Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë

Nga viti 2009 deri në vitin 2016, programi është udhëhequr nga Dr. Narasimha Rao Vajjhaja (PhD nga Universiteti i Phoenix, SHBA) dhe nga viti 2016 deri tani nga Assoc. Prof. Dr. Marenglen Biba. Përgjegjësi i programit ka titullin "Profesor i asociuar"

Te gjitha lendet mbulohen nga personeli akademik, minimalisht me gradë shkencor "Doktor", me përvojë më të gjatë se 5 vjet. [dok" Orari i programit për brezin 8"], [dok

<p>profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>”Dosja e programit. CV e stafit”].</p> <p>Rektori, Zëvendës Rektori, Dekani, Drejtori i Programit, Drejtori i Departamentit janë të gjithë të punësuar si personel akademik efektiv në UNYT.</p> <p>Studentëve u caktohet një udhëheqës gjatë përgatitjes së tezës së masterit. Procesi i udhëheqjes së diplomave përkruhet në udhëzuesin e projektit final dhe dizertacionit.[dok “Udhëzues për projektin final dhe dizertacionin”]</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentëve u caktohet një udhëheqës gjatë përgatitjes së tezës së masterit. Ngarkesa e punës për tezën është 480 orë punë e pavarur nga student prej gjashtë muajsh. [dok “Mesazh nga drejtori i programit për ftesën për përzgjedhjen e mbikëqyrësit”].</p> <p>Udhëheqësit e diplomave kanë të paktën gradë shkencore “Doktor” dhe kanë numër të barabartë studentësh. [Takimi me stafin akademik]</p> <p>Studentët mund të zgjedhin udhëheqësin në përputhje me interesat e tyre duke paraqitur një propozim për temën. Propozimi miratohet nga udhëheqësi dhe koordinatori. [dok “Shembull i propozimit të disertacionit të paraqitur për miratim”]</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit e diplomave kanë të paktën gradë shkencore “Doktor” në shkencat kompjuterike dhe kanë botime shkencore në fushën perkatese. [dok “Lista e temave të dërguara për studentët që pasqyrojnë fushat e interesit kërkimor.”], [dok “Dosja e programit. CV e stafit”]</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UNYT ofron shërbime për realizimin e orëve mesimore, sic janë laboratorët e kompjuterave dhe pajisjet IT, të cilat administrohen me procedura të qarta për mirëmbajtjen dhe përmirësimin hardware dhe software.</p> <p>[dok “Dokument mbi shërbimet mbështetëse të TI-së”]</p> <p>[dok “Dokument mbi Operimin dhe Asetet e TI”]</p> <p>[dok “Dokumenti i politikave të sigurisë së TI”]</p> <p>Programi MSc ka një koordinatror administrativ i programit. Zyra e Masterit, merret me të gjithë logjistikën, oraret dhe</p>

çështjet e tjera administrative që lidhen me programin.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike ofron programet e studimit BSc dhe MSc, por me numrin modest 7 PAE gjendet para situatës së mbingarkesës së tyre, në rast se do të sigurojë raportin 70 % të ngarkesës të mbuluar me staf akademik të brendshëm.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike zbaton procedura transparente për ndarjen e ngarkesës mësimore dhe vlerësimin e performancës së mësimdhënies. [dok "Modeli i vlerësimit të kursit nga studentët e MSc."], [dok "Vlerësimi individual vjetor i performances."], [dok "Formulari i vlerësimit të profesorëve nga kolegët"], [dok "Sistemi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore në Fakultetin e Informatikës"], [Takimi me drejtuesit dhe stafin akademik]

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Në Zyrën e Burimeve Njerëzore gjenden të dhëna të hollësishme për anëtarët e personelit akademik, ndihmës, dhe administrative. Ka një listë të plotë të personelit akademik me lëndët përkatëse sipas semestrave. UNYT ka procedura transparente dhe të qarta për rekrutimin e personelit akademik.

[dok "Njoftimi i shpalljes së vendit të lirë jashtë vendit"]

[dok "Lajmërim i vendit të lirë publikuar në internet"]

[dok "Njoftim për vend të lirë pune në gazetë"]

Konkluzionet e vlerësimit:

Stafi akademik dhe administrativ i programit të studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është i angazhuar në përputhje me objektivat e programit dhe në realizimin e programit në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it, Londër, Mbretëria e Bashkuar.

Departamenti zbaton procedura transparente për vlerësimin e performancës në mësimdhënie. Vlerësimi kryhet nga studentët e programeve si dhe nga antaret e tjerë të departamentit. Zyra e Burimeve Njerëzore mban të gjitha të dhënat e personelit.

Stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar, me aktivitet të pasur akademik.

Raportet PAE/PAK janë në vlerat (36-57)% / (43-64)%

Ngarkesa mësimore e mbuluar nga PAE është mbi 70% e ngarkesës mësimore të programit të studimit per vitin 2018-2019.

Vihet re një mbingarkesë e stafit të brendshëm me disa lëndë.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Që nga Tetori 2014, UNYT ndodhen në "Kodrën e Diellit". Godina kryesore e Universitetit është e përbërë nga 7 kate, në të cilën ndodhen salla për leksione, laboratorët mësimor të informatikës, salla për bibliotekën, zyrat për stafin akademik dhe administrative [dok "Dokumenti i kampusit, godinës dhe infrastrukturës"]. Në godinën e dytë ndodhen disa salla për leksione si dhe qëndrat kërkimore. GVJ vizitoi të gjitha ambientet e vëna në dispozicion të këtij program studimi dhe evidentoi se institucioni ka infrastrukturën e nevojshme, për zhvillimin e një procesi normal të mësimdhënies. Ambjentet janë të përshtatshme për leksione, laboratorë dhe veprimtari të tjera. Infrastruktura dhe sallat janë në përputhje me standartet teknike për mësimdhënie. E gjithë godina mbulohet nga rrjet interneti wireless, e disponueshme për të gjithë. Laboratorët e kompjuterave janë plotësisht në funksion të programit të studimit për nga përbërja e pajisjeve dhe software-ve të tyre. Biblioteka e është e hapur çdo ditë dhe ka një numër të konsiderueshem të librave, revistave dhe publikimeve të tjera shkencore [dok "Politikat dhe asetet e bibliotekës"]. UNYT ju ofron studentëve të shfrytëzojnë dhe burime nga universitetet partnere të tij si dhe software si Turnitin (turnit.com) për kontroll të plagjaturës .

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit janë paraqitur në Tabela 7 në Aneks. Vihet re se infrastruktura dhe mjediset e UNYT për programin e studimit janë të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore; Kriteri 2 Keto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet; Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron; Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	UNYT ndodhen në "Kodrën e Diellit" që nga Tetori 2014. Godina kryesore e Universitetit është e përbërë nga 7 kate, në të cilën ndodhen salla për leksione, laboratorët mësimor të informatikës, salla për bibliotekën, zyrat për stafin akademik dhe administrative
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore; Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e	Biblioteka e UNYT ka një fond librash të konsiderueshëm që shërbejnë si tekste mësimore dhe

<p>ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>literaturë ndihmëse.</p> <p>Ka një marrëveshje midis McGraw-Hill dhe UNYT. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë të aksesojnë bibliotekën virtuale të McGraw-Hill. [dok "Biblioteka UNYT"].</p> <p>Biblioteka i ka oraret të shpallura dhe në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p> <p>Biblioteka është e vendosur në ndërtesën kryesore në katin e dytë. Biblioteka është e pajisur me 20 kompjutera dhe me shërbim interneti.</p> <p>Biblioteka e UNYT pasurohet çdo vit me tituj të rinj. [dok "Politikat dhe asetet e bibliotekës"]. [http://unyt.edu.al/facilities-3]</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>UNYT ka infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor. [dok "Evidenca e Infrastrukturës"].</p> <p>Laboratorët e kompjuterave kanë pajisje dhe software me specifikime e mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit. Zyra e IT është përgjegjëse për asistencë teknike në laboratorë [dok "T Support Services"]. Cdo klasë dhe auditor është i pajisur me kompjuter për pedagogun, si dhe me projektor. Në laboratorët e kompjuterave dhe në ambjentet e tjera të UNYT ka akses në Internet.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Infrastruktura dhe mjediset e UNYT për programin e studimit MSc në Shkenca Kompjuterike janë të përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p>Laboratorët janë të pajisur me kompjutera dhe software të nevojshëm për zhvillimin e gjithë procesit mësimor. Sallat dhe auditorët i plotësojnë standartet dhe kriteret e cilësisë.</p> <p>Biblioteka ka një numër të konsiderueshëm të librave, revistave dhe publikimeve të tjera shkencore. Në laboratorët e kompjuterave dhe në ambjentet e tjera të UNYT ka akses në Internet.</p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Referuar RVB [fq 38], Zyra e Financës në UNYT është e ngarkuar për zbatimin e politikës financiare institucionale.

Universiteti i New York-ut në Tiranë kryen auditime të brendshme dhe të jashtme në baza vjetore. Auditimi i brendshëm [dok "Internal Finance Auditing Report 2015-2016"] kryhet nga Komisioni i

emëruar nga bordi i aksionerëve të Universitetit, ndërsa auditimi i jashtëm kryhet nga një kompani e pavarur auditimi që kryen veprimtarinë e saj në Shqipëri. [RVB, fq 38].

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit

Tabela 8 në Aneks detajon të ardhurat në lekë. Të dhënat tregojnë për mundësitë financiare të Institucionit për të përballuar procesin mësimor në programin e studimit.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Në fund të çdo viti akademik, UNYT bën një analizë të koston për të gjitha programet e studimeve: [referuar RVB fq 39].

Kostoja / viti për studentët e programit është paraqitur Tabela 8 në Aneks, ku mesatarisht në një vit kostoja është 4838 euro për diplomën të lëshuar vetëm nga UNYT dhe 7327 Euro për diplomën e dyfishtë me UoG.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficientësinë e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>UNYT është subjekt i auditimit vjetor të brendshëm dhe të jashtëm, të situatës financiare të tij [dok "Raporti i auditimit të brendshëm financiar për vitin 2012-2013"], [dok "Raporti i auditimit të jashtëm për projektin kërkimor të RRPP, viti 2014-2015], [dok "Raporti vjetor 2017-2018"], [dok "Raporti i auditimit të brendshëm financiar për vitin 2015-2016"]]</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>UNYT harton raport vjetor mbi koston-efektivitetin e secilit program studimi duke analizuar shpenzimet [dok: "Raporti Vjetor 2017-2018"].</p> <p>UNYT i dokumenton raportet financiare</p> <p>Referuar RVB ,në 6 vitet e fundit UNYT paraqet një diferencë mesatare prej 6% të fitimit. UNYT dëshmon qëndrueshmëri financiare.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Mbi bazën e dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe RVB, UNYT vlerëson dhe dokumenton gjendjen financiare, harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</p> <p>UNYT dëshmon qëndrueshmëri financiare.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në UNYT është institucionalizuar si një strukturë organizative e funksionimit të strukturave të përhershme: Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të UNYT, i cili siguron dhe monitoron cilësinë e mësimdhënies në bashkëpunim me koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë [RVB fq 43], [dok "Plani Strategjik i UNYT, 2018-2022"]. Procedurat e Sigurimit të Cilësisë të zbatuara nga UNYT janë zhvilluar në përputhje me praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare [Takimi me QSBSC].

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit (KPSSCI) është zgjedhur nga Senati Akademik [dok "Statuti i UNYT, Neni 28"]. Komisioni i përhershëm përbëhet nga drejtori dhe 5 anëtarë, që përfaqësojnë të gjitha fakultetet, studentët dhe një anëtar të jashtëm [Takimi me QSBSC].

Proceset e sigurimit të cilësisë janë ndihmuar edhe nga pjesëmarrja e UNYT si partner në projektin Erasmus+: QainAL - "Mbështetje Strategjike për Forcimin e Strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet Private të Arsimit të Lartë në Shqipëri". Angazhimi në projekt dhe trajnimet e marra, kanë shërbyer në përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë [RVB fq 43], [Takimi me QSBSC].

Tregues të matshëm:

Të dhëna për anëtarët e NJBSC janë paraqitur në Tabelën 9 në Aneks.

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:

Në programin MSc në Shkenca Kompjuterike janë kryer procese vlerësimi nga studentë nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të të gjitha kurseve të marra. Ky proces është koordinuar nga Zyra e Programeve Master dhe nga zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe është mbikëqyrur nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit (KPSSCI), ndërsa rezultatet përfundimtare të vlerësimit janë shqyrtuar në nivel departamenti dhe kanë qenë pjesë e analizës së performancës së departamentit dhe sigurimit të cilësisë. Vlerësimet e studentëve janë bërë nga studentët në fund të çdo kursi, para se të kryhet provimi përfundimtar.

Në MSc në Shkenca Kompjuterike janë bërë 96 vlerësime bazuar në kurset e gjashtë viteve të fundit, 2012-2018. [dok "Vlerësime të kryera nga Studentët e Masterit në Shkenca Kompjuterike 2012-2018"].

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Format e vlerësimit të stafit akademik përbëhen nga vlerësimet e studentëve në bazë të çdo kursi, vlerësimet e kolegëve, vlerësimin e performancës individuale nga fakulteti, si dhe vlerësimin në raportet vjetore mbi mësimdhënien, të nxënit, dhe standardet e lidhura me cilësinë, të përpiluar nga secili departament në fund të çdo viti akademik [dok "Modeli i vlerësimit të kursit nga studentët e MSc."], [dok "Vlerësimi individual vjetor i performances"], [dok "Formulari i vlerësimit të profesorëve nga kolegët"], [dok "Shembulli i Raportit Vjetor të Departamentit"], [dok "Sistemi i vlerësimit të punës kërkimore në Fakultetin e Informatikës"], [dok "Shembulli i raportit vjetor të paraqitur në Universitetin e Greenwichit"].

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti.

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë dhe Koordinatorin e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me Dekanët e Fakulteteve, Drejtorët e Departamenteve që mbulojnë programin, janë

përgjegjës për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies [RVB fq 47].

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

UNYT kryen vlerësime të tjera në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it, për të garantuar që programi po funksionon sipas standardeve. Këto vlerësime mund të ndahen në vlerësime vjetore dhe vlerësime të rishikimit të programit që zbatohet çdo pesë vjet bashkëpunimi. [dok "Shembulli i Raportit Institucional dorëzuar Universitetit të Greenwich"], [dok "Vlerësimi Kritik i UNYT nga Universiteti Greenwich - Rishikimi i Programit Shtator 2014"].

Politikat e përmirësimin të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Procedurat e Sigurimit të Cilësisë rishikohen, raportet e cilësisë me rekomandimet përkatëse i dorëzohen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe të Senatit.[RVB fq 47].

Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme

Referuar RVB dhe takimit me drejtuesit e programit të studimit, Programi MSc në Shkencat Kompjuterike menaxhohet dhe monitorohet nga UNYT dhe UoG si me poshte:

- Drejtor i Programit: Assoc. Prof. Marenglen Biba, i emëruar nga UNYT.
- Koordinator programi (Link Tutor): Prof. Lachlan M. MacKinnon, i emëruar nga UoG.
- Ekzaminues i jashtëm: Prof. Anthony T Whitehouse, i emëruar nga QAA në UoG.
- Zyrtar i Lartë Administrativ (Partneritetet Ndërkombëtare): Freddy Trott, i emëruar nga UoG
- Zyrtar i Cilësisë: Znj. Heather Baynes, Njësia e Cilësisë Akademike në UoG.
- Koordinator i programeve Master: Znj. Nertila Paskali, emëruar nga UNYT.

Komisioni i mësipërm mblidhet një herë në vit për të kontrolluar progresin e programit. Ky takim vjetor i rishikimit me ekipin UoG i cili quhet BPV (Bordi i Progresit dhe Diplomimit), analizon performancën e përgjithshme të programit dhe miraton përparimin e secilit nxënës. [dok "Universiteti i Greenwich – UNYT, procesverbali i Bordit të Progresit dhe Diplomimit"]

Përveç kësaj, një herë në vit Koordinatori i programit (Link Tutor) viziton UNYT dhe kryen një kontroll të plotë të dokumentacionit të programit, provimeve me përgjigjet e studentëve, procesit të vlerësimit dhe notave, laboratorëve dhe statusit të pajisjeve, statusit të bibliotekës, etj. [dok "Universiteti i Greenwich – UNYT Raporti i Vizitës të Sigurimit të Cilësisë"]

Përveç mbledhjes së BPV, UNYT i paraqet UoG një raport mbi vlerësimin vjetor për të siguruar se të gjitha procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë ndjekur në mënyrë korrekte dhe programi është drejtuar sipas standardeve të miratuara. [dok "Shembulli i raportit vjetor të paraqitur në Universitetin e Greenwichit"], [dok "Përgjigje e UoG mbi raportin vjetor të dorëzuar nga UNYT"].

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	

Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista; Etj.

Të drejtpërdrejta:

- Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);
- Dëgjime në auditor;
- Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; tj.

UNYT përdor instrumentet e matjes dhe vlerësimit, të metodologjive vlerësuese, të cilat përbëhen nga vlerësimet e studentëve në bazë kursi, vlerësimet e kolegëve, formën individuale të vlerësimit të performancës së profesoreve, si dhe vlerësimin në raportet vjetore mbi mësimdhënien, të nxëniet dhe standardet përkatëse të cilësisë të përpiluara nga secili Departament në fund të vitit akademik.

UNYT e kryen vlerësimin duke përdorur të gjitha instrumentet horizontale dhe të tërthorta, me studentë, të diplomuar, ish studente, staf akademik dhe administrativ.

Vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike dhe konkluzionet si dhe komentet bëhen publike tek instruktorët përkatës sapo lënda të jetë zhvilluar plotësisht. Drejtori i Departamentit si dhe Dekani janë të informuar në detaje në lidhje me rezultatet e procesit dhe kanë mundësinë për të propozuar përmirësime, kur është e nevojshme.

Raporti Vjetor Institucional miratohet nga Senati dhe behet publik për të gjithë aktorët.

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Programi i studimit Msc Shkenca Kompjuterike është i disponueshëm në faqen institucionale (<http://unyt.edu.al/programs/graduate/>;) dhe publikohet në Librin e Studentit [dok "Libri i Studentit"]

UNYT publikon rregullisht manuale dhe broshura, të cilat janë të disponueshëm për studentët në ambientet e UNYT-së, në hollin e pritjes, që të mund të përdoren nga studentët për konsultim. Plani mesimor publikohet në faqen e internetit të UNYT (<http://unyt.edu.al/courses/us-history-ii/>), dhe një kopje fizike ju jepet studentëve në orën e tyre të parë në javën e parë.

Kriteret e pranimit të studentëve përfshihen në materialet promocionale, në Buletinin e UNYT, i deklaruar në Ministrinë e Arsimit dhe në agjencitë kompetente, dhe publikohet në faqen e internetit të UNYT-it [<http://unyt.edu.al/admissions/undergraduate/application-process/>] dhe në portalin U-Albania.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

UNYT kryen një takim vjetor të vlerësimit të programit me grupin e punës së Universitetit të Greenwich-it referuar si Bordi i Progresit dhe Diplomimit (BPD). Ky takim analizon ecurinë e përgjithshme të programit dhe miraton ecurine e secilit student. [dok "Universiteti i Greenwich – UNYT, Procesverbali i Bordit të Progresit dhe Diplomimit"].

Ekipi i Sigurimit të Cilësisë së UoG-it kontrollon provimet se bashku me përgjigjet e studentëve, procesin e vlerësimit, laboratorët dhe gjendjen e pajisjeve, gjendjen e bibliotekës [dok "Universiteti Greenwich - UNYT Raporti Vjetor i Sigurimit të Cilësisë"].

UNYT paraqet një raport ne UoG-së si një analizë vjetore në nivel institucional për procesin e zhvillimit të programit Master. [dok "Shembulli i Raportit Institucional dorëzuar Universitetit Greenwich"]

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashërshme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

UNYT është akredituar plotësisht në vitin 2006 dhe u riakreditua në nivel institucional në vitin 2015.

UNYT është riakredituar institucionalisht nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, bazuar në vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 102, dt.10.11.2017.

UNYT përdor të gjitha instrumentet për të forcuar Sigurimin e Cilësisë, si Manuali i Sigurimit të Cilësisë, Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit, Komisioni i Etikës, Komisioni për Peticionet Akademike dhe strukturat më të larta mbikëqyrëse, ku palët e interesuara: si përfaqësuesit e studentëve, stafit akademik dhe administrativ janë pjesë e procesit të vlerësimit dhe mbikëqyrjes.

UNYT në bazë të politikës së tij të përgjithshme për të siguruar cilësinë e çdo programi studimor në përputhje me standardet e kërkuara nga Kuadri Ligjor Shqiptar ka Statutin, planin strategjik të UNYT dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë.

Mekanizmat formale për rishikimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit; janë rishikimi i planit mesimor në fillim të çdo semestri dhe rishikimi periodik që aprovet nga Senati.

Pjesëmarrja e studentëve në nivelet e vendimarrjes është e detyrueshme. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senat, Këshillin e çdo Fakulteti dhe Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së institucionit etj. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet

Keshillit Studentor ,i cili përfaqëson interesat e studentëve në UNYT dhe zgjidhet çdo vit nga votat e studentëve [dok “Plani Strategjik I UNYT, 2018-2022”], [dok “ Manuali i Sigurimit te Cilësisë 2018”]

UNYT në bashkëpunim me Universitetin Greenwich, zhvillon vlerësime te vazhdueshme për të garantuar që programi po funksionon sipas standardeve te përcaktuara. Këto vlerësime mund të ndahen në vlerësime vjetore dhe vlerësime te rishikimit të programit i cili zbatohet çdo pesë vjet bashkëpunimi. [dok “Shembulli i Raportit Institucional dorëzuar Universitetit të Greenwich”].

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konstatoi se Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është institucionalizuar në Komisionin e Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë, i cili siguron dhe monitoron cilësinë në UNYT.

UNYT kryen vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, duke përdorur instrumente të ndryshme përfshirë vlerësimet e studentëve, të diplomuarave, ish studenteve, stafit akademik dhe administrativ. Programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike i nënshtrohet një vlerësimi vjetor nga Universiteti i Greenwich-it i nëpërmjet Bordit të Progresit dhe Diplomimit.

UNYT paraqet një raport vjetor në UoG si dhe një analizë në nivel institucional për procesin e zhvillimit të programit te studimit. Raportet bëhen publike për studentët dhe të interesuarit e tjerë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e programit të studimi MSc në Shkenca Kompjuterike gjejmë të përcaktuar qartë misionin, që synon t’i ofrojë studentëve mundësinë për të eksploruar dhe studiuar, në fusha të shkencave kompjuterike të njohura ose në zhvillim të shpejtë nëpërmjet një qasje akademike dhe profesionale. Qëllimi themelor i programit është të zhvillojë tek studentët konceptet dhe parimet kryesore në fushën e shkencave kompjuterike.

Referuar RVB, objektivat mund të përmblihen si më poshtë.

- Pajisja e studentëve, që vijnë nga disiplina të ndryshme nga (por lidhur me) Shkencat Kompjuterike, me bazat e nevojshme në mënyrë që ata të mund të ndjekin studimet pasuniversitare.
- Pajisja e studentëve me mjetet, njohuritë baze dhe të detajuara sipas nevojës për te ndihmuar në studimet e mëtejshme të doktoraturës në Shkencat Kompjuterike.

- Edukimi i studentëve me mjetet, konceptet dhe metodologjinë e kërkuar për kërkim shkencor të pavarur. Udhëzimi nëpër të gjitha fazat e ndryshme të procesit.
- Trajnimi i studentëve në mënyrë që ata të jenë në gjendje të analizojnë, zhvillojnë dhe mirëmbajnë sisteme komplekse kompjuterike.
- Trajnimi i studentëve me punë praktike të orientuara drejt certifikatave profesionale që do të jenë të dobishme për karrierën e tyre të ardhshme në industri.

Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike ofrohet për studentët e rinj, punonjësit e sektorit privat dhe publik. Programi mbulon disa nënfusha në fushën e shkencave kompjuterike ku përfshihen rrjetat e kompjuterave, inxhinieria e softuerit, bazat e të dhënave, si dhe në fushën e menaxhimit, menaxhimi strategjik. Studentët që përfundojnë programin mund të punësohen si inxhinierë softueri, analist sistemi, specialist rrjetash, administrator bazash së të dhënave, programues i faqeve të internetit, mësimdhënie në universitet dhe kërkimin e mëtejshëm shkencor.

Plani mësimor përmban shtatë kurse bazë duke përfshirë një kurs për metodologjinë e kërkimit dhe tre kurse opsionale në tre specializimet: rrjetat kompjuterike, bazat e të dhënave dhe inxhinieri softueri. Studentët gjithashtu kanë mundësinë e përzgjedhjes së specializimit të përgjithshëm që u lejon atyre të zgjedhin një kombinim të kurseve nga të tre fushat e specializimit. Pas përfundimit të të gjitha kurseve, studentët duhet të paraqesin një teme .

Tregues të matshëm:

- Viti i fillimit, e programit të studimit

Programi i Studimit MSc në Shkenca Kompjuterike ofrohet që nga viti 2009, nga Universiteti i New York në Tiranë në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich, Londër, Mbretëria e Bashkuar.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi zhvillohet në një periudhë prej dy vitesh dhe organizohet si më poshtë:

Programi parapërgatitor fillon në Nëntor të çdo viti dhe përfundon në fund të Shkurtit.

semestri i parë fillon në Mars deri në muajin Maj,

semestri i dytë zgjat nga Korriku deri në Tetor,

semestri i tretë nga Nëntori deri në Mars, dhe

semestri përfundimtar i dedikuar për projektin përfundimtar dhe temen, fillon në Prill dhe zgjat deri në Tetor.

Organizimi i programit të studimit:

- 1 vit akademik ka 20 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 10 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

[dok "Kurrikula e MSc ne Shkenca Kompjuterike, Cohort-8."]

- Emërtimi i Diplomës është : MSc në Shkenca Kompjuterike

Përfundimi i plotë i programit me 240 kredite Britanike, çon në një diplomë të dyfishtë: një MSc në Shkencat Kompjuterike të dhënë nga Universiteti i New York-ut në Tiranë dhe diploma përkatëse e dhënë nga Universiteti i Greenwich, Londër, UK. Në të gjitha rastet kur një student nuk e ka përfunduar programin e plotë, parashikohet një diplomë e pjeshme si me poshte:

- *Certifikatë pasuniversitare* – i jepet studentit që përfundon me sukses të paktën 60 kredite (BCTS)
- *Diplomë e Pjeshme Pasuniversitare* - i jepet studentit që përfundon me sukses të paktën të paktën 120 kredite (BCTS). [dok “ Suplementi i Diplomës, MSc në Shkenca Kompjuterike”]

Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10 në Aneks.

- Programi Parapërgatitor: 30 Kredite Britanike (15 ECTS)
- 7 Kurse Themelore, 15 Kredite Britanike secila (52.5 ECTS)
- 3 Kurse të specializuara: 15 kredite Britanike secila, (22.5 ECTS)
- 1 Projekt: 60 Kredite Britanike (30 ECTS)
- Totali: 240 BCTS Kredite Britanike (120 ECTS)

Ekivalenca e krediteve britanike me ECTS është bërë në mënyrë që studentët të marrin 120 kredite Britanike në vit ose 60 kredite në vit sipas ECTS.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

GVJ konstatoi se lëndët zhvillohen në mënyrë integrale duke mos ndarë në leksione, seminare, ushtrime apo laboratore. Të gjithë këto komponentë zhvillohen bashkë si pjesë e leksionit.

Në këtë rast nuk respektohen kriteret e standarteve shqiptare, ndaj është e vështirë të gjykohet nëse në një vit akademik realizohen min 600 orë në auditor, duke u bazuar në atë që , leksionet kanë 40 orë në auditor [RVB fq 57].

Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese paraqitet në Tabelën 11 në Aneks.

Në veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) është gjykuar të vendosen lëndët e programit parapërgatitor. Teza e diplomës është 30 kredite , 750 orë nga të cilat 480 orë punë të pavarur e studentit.

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara janë Tabela 12 në Aneks.

Institucioni ka paraqitur një sërë ndryshimesh në planin mesimor të miratuar në hapjen e programit të studimit., gjykojme se nuk ka ndryshime rrënjësore të cilat kanë çënuar objektivat e programit të studimi, por përkundrazi e kanë forcuar atë. GVJ konstatoi se UNYT është i angazhuar në rishikimin e vazhdueshëm të planit mësimor në përputhje me zhvillimet e fundit. Për këtë qëllim, universiteti kryen një proces të quajtur vlerësimi i kolegëve në të cilin kryhet edhe kontrolli i planit mësimor. [dok “Formulari i vlerësimit të profesorëve nga kolegët”]. Bazuar në marrëveshjen me Universitetin Greenwich (UoG), syllabuset e lëndëve kalojnë një miratim paraprak nga UoG. Megjithatë ka akoma nevojë për më shumë përpjekje për të integruar lëndë të diktuar nga kërkesat e tregut lokal të punës.

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës në Tabela 13 në Aneks.

Nga të dhënat vihet re që stafi akademik është i kualifikuar , në përputhje me programin e studimit master i Shkencave. Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin master është gjithashtu i angazhuar në botimin e kërkimeve shkencore që publikohen rregullisht në revista shkencore e konferenca. Programet për çdo lëndë.:

GVJ konstatoi se programet e lëndëve janë hartuar në bashkëpunim me Universitetin Greenwich-it i cili miraton këto programe lëndësh para se të ofrohen kurset. Programet e lëndëve janë përgatitur sipas krediteve britanike, në bazë të udhëzimeve të bashkëpunimit duke respektuar standardet e Universitetit Greenwich [dok “Lista e programeve të lëndës, Dosja e Programit”].

Përmbajtja e programeve të lëndëve është e plotë dhe bashkekohore por ndarja në kredite për çdo formë të mësimdhënies mungon. Ndarja në kredite sipas të gjitha formave të mësimdhënies do të japë një pamje më të qartë të peshës që zë gjithë secila dhe do t’i japë më shumë vlera aspektit praktik dhe profesional.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it dhe është zhvilluar sipas standardeve britanike në lidhje me kreditet. Ekuivalenca e krediteve britanike me ECTS është bërë në mënyrë që studentët të marrin 120 kredite Britanike në vit ose 60 kredite në vit sipas ECTS. [dok “Dokumenti i Programit”], [dok “Suplementi i Diplomës, MSc në Shkenca Kompjuterike”]</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p>Programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është hartuar për të vazhduar dhe zgjeruar njohuritë në lëndët e fituara në ciklin e parë të studimeve si në Inxhinieri Softi, në Bazat e të Dhënave dhe në Rrjeta kompjuterike.</p> <p>Programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike, ka module që i orientojnë studentët në metodat e kërkimit shkencor. Të gjitha kurset kanë në komponentët e vlerësimit, një komponent praktik i cili shkon nga 40-50% e vlerësimit total të kursit. [dok “Dokumenti i Programit”].</p> <p>[dok “Libri i Studentit”].</p>

<p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi është hartuar për të ofruar njohuri të avancuara në fushat përkatëse të shkencave kompjuterike. Përmbajtja e programeve të lëndëve është në nivelin master, duke synuar dhënien e njohurive të avancuara mbi ato të nivelit bazë.</p> <p>Në cdo lëndë ka dy lloje vlerësimi. Këto janë të parashikuara në planin mësimor dhe përbëhen nga provimi përfundimtar dhe detyra e kursit, në mënyrë që të vlerësojnë pjesën teorike dhe aftësitë praktike që duhet të fitohen nga lënda. Bazuar në bashkëpunimin me Universitetin e Greenwich, procedura e kontrollit të njohurive të studenteve në të gjitha aspektet bëhet edhe nga një ekspert i jashtëm i emëruar nga UoG.</p> <p>[dok “Skema e Vlerësimit për Provimin e kursit Data Mining, 2014”]</p> <p>[dok “Skema e Vlerësimit për Projektin e kursit Data Mining, 2014”]</p> <p>[dok “Komente të Vlerësuesit të jashtëm për Komponentet e kurseve”]</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesore, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuara në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi ofrohet që nga viti 2009 në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich, Londër, UK. Plani mesimor është zhvilluar së bashku me UoG dhe para se të zbatohet është miratuar zyrtarisht nga komisioni i UoG.</p> <p>[dok “Memorandumi i Marrëveshjes UoG-UNYT”].</p> <p>[dok “Letër Përgjigje-je e UoG drejtuar AIR mbi raportin vjetor të dorëzuar nga UNYT”]</p> <p>Programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike ofrohet në gjuhën angleze dhe jep dy diploma, në bashkëpunim me UoG, në këtë kontekst është konkurrenca si në nivel kombëtar ashtu dhe ndërkombëtar.</p> <p>Programi synon respektimin e legjislacionit dhe direktivave të BE-së për arsimin e lartë duke ofruar ekuivalentin e 120 ECTS me standardin britanik të krediteve.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e</p>	<p>Programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është hartuar në përputhje me profilin e UNYT dhe strategjinë e tij për zhvillim. Programi ka kurse me përmbajtje shkencore, por edhe ato me përmbajtje praktike siç janë platformat të Cisco-s për rrjetat, të Oracle për bazat e të</p>

<p>tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>dhënave, dhe ato të Microsoft e Oracle për inxhinierinë e softit.</p> <p>[Takimi me stafin akademik], [dok "Lista e programeve të lëndëve, Dosja e Programit"]</p> <p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin master është gjithashtu i angazhuar në botimin e kërkimeve shkencore që publikohen rregullisht në revista shkencore e konferenca.</p> <p>[dok "Dosja e programit; CV e stafit"].</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>N/A</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>UNYT ka ndërmarrë disa anketime gjatë viteve, në mënyrë që analiza e kërkesave të tregut të punës të përdoret si bazë për përmirësimin e programit të studimit, në mënyrë që programi i studimit të jetë në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p>[dok "Anketim për Përmirësimin e Programit Parapërgatitor"], [dok "Anketim i Studentëve"], [dok "Anketim për Punëdhënësit"].</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtarë;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Sipas Statutit të UNYT, universiteti ofron programe që nuk bien ndesh me asnjë nga interesat kombëtare. Qëllimi i programit MSc në Shkenca Kompjuterike është ai i krijimit të ekspertizës së avancuar në vend, që është në përputhje me interesin kombëtar.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezhën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite</p>	<p>Programi ofrohet gjatë një periudhe prej dy vjetësh, me një total prej 240 kreditesh britanike ose 120 ECTS. Projekti përfundimtar llogaritet 60 kredite britanike ose 30 ECTS. Organizimi i përgjithshëm i programit në kredite respekton strukturën e përgjithshme evropiane për programet Master dhe është në përputhje me ligjet në fuqi.</p>

<p>akademike.</p> <p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>[dok “Dokumenti i Programit”]</p> <p>[dok “Memorandumi i Marrëveshjes UoG-UNYT”]</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>UNYT organizon ditën e orientimit për të informuar studentët e regjistruar në lidhje me çdo aspekt të programit të studimit, apo edhe informacioneve të tjera të nevojshme.</p> <p>[dok “Prezantimi për Ditën e Orientimit”]</p> <p>[dok “DVD me material Orientues për studentët”].</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Studentët ndiqen gjatë periudhës së studimeve nëpërmjet Komisionit të Programit, i përbërë nga drejtuesi i programit, pedagogë të programit, dhe dy anëtarë të studentëve të zgjedhur nga vetë studentët. [dok “Procesverbali i Mbledhjes së Komisionit të Programit”].</p> <p>Projekti përfundimtar, teza llogariten me 60 kredite britanike ose 30 ECTS dhe parashikohen rreth gjashtë muaj për zbatimin e këtij projekti nga studenti.</p> <p>[dok “Dokumenti i Programit”]</p> <p>[dok “Udhëzimet e Disertacionit në Shkencat Kompjuterike MSc-UNYT-UoG”]</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>GVJ konstatoi se programi i studimit MSc në Shkenca Kompjuterike është hartuar në përputhje me profilin e UNYT dhe strategjinë e tij për zhvillim. Programi i studimit master ofrohet gjatë një periudhe prej dy vjetësh, me një total prej 240 kreditesh britanike ose 120 ECTS. Projekti përfundimtar, teza, llogaritet 60 kredite britanike ose 30 ECTS.</p> <p>Lëndët sipas planit mësimor zhvillohen në mënyrë integrale duke mos ndarë sipas formave të mësimdhënies në leksione, seminare, ushtrime apo laboratore. Të gjithë këto komponentë zhvillohen bashkë si pjesë e leksionit, por GVJ sugjeron se ndarja në kredite sipas të gjitha formave të mësimdhënies do të japë një pamje më të qartë të peshës që zë gjithësecila prej tyre.</p> <p>Programi master është projektuar për të vazhduar dhe zgjeruar njohuritë në lëndët e fituara në ciklin e parë të studimeve. Bazuar në bashkëpunimin me Universitetin e Greenwich, procedura e kontrollit të njohurive të studenteve në të gjitha aspektet bëhet edhe nga UoG.</p> <p>UNYT organizon ditën e orientimit për të informuar studentët e regjistruar në lidhje me çdo aspekt të programit të studimit, apo edhe informacioneve të tjera të nevojshme UNYT ka ndërmarrë disa anketime gjatë viteve, duke bërë përpjekje që analiza e kërkesave të tregut të punës të përdoret si bazë për përmirësimin e programit të studimit. Megjithatë ka akoma nevojë për më shumë përpjekje për të integruar</p>	

lëndë të diktuar nga kërkesat e tregut të punës. Studentët ndiqen gjatë periudhës së studimeve nëpërmjet Komisionit të Programit, ku përfshihet edhe zhvillimi i tezës. Stafit akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është gjithashtu seriozisht i përfshirë në aktivitete shkencore, pjesëmarrje në konferenca publikime në revista.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Referuar RVB dhe vizitës në UNYT, GVJ konstatoi se Programi MSc në Shkenca Kompjuterike u jep studentëve një diplomë të dyfishtë: një MSc në Shkenca Kompjuterike të dhënë nga Universiteti i New York-ut në Tiranë dhe një diplomë përkatëse MSc nga Universiteti i Greenwich-it. Të dy universitetet kanë rënë dakord për procedurat e përbashkëta në lidhje me mësimdhënien dhe diplomimin si më poshtë [RVB fq 64]:

- Performanca në programet MSc vlerësohet numerikisht. Niveli i kalueshmërisë është 50%.
- Lëshohet një diplome pasuniversitare me vlerësimin “Shkëlqyeshem”, kur studentët marrin mesatarisht notën mbi 70%. Kandidatët që nuk arrijnë 70% mund të konsiderohen gjithashtu për vlerësimin “Shkëlqyeshem” nëse performanca e jashtëzakonshme në kurse të veçanta dhe përmirësimi gjatë gjithë programit mund të evidentohen.
- Lëshohet një diplome pasuniversitare me vlerësimin “Mirë”, kur studentët marrin mesatarisht notën 60-69%. Kandidatët që nuk arrijnë 60% mund të konsiderohen gjithashtu për vlerësimin “Shumë mirë” nëse performanca e jashtëzakonshme në kurse të veçanta dhe përmirësimi gjatë gjithë programit mund të evidentohen.
- Lëshohet një diplome pasuniversitare me vlerësimin “Kalues”, kur studentët marrin mesatarisht notën 50-59%.
- Procedura e Kompensimit mund të aplikohet për programet pasuniversitare. Brenda një diplome, procedura e kompensimit mund të aprovohet vetëm për një maksimum prej 30 kredive për një kurs (ose kurse) që arrin një notë prej 35-39%. Procedura e Kompensimit nuk është një e drejtë automatike, por është një vendim i marrë nga Bordi i Progresit dhe Vlerësimit kur profili i një studenti individual konsiderohet në mënyrë të plotë, duke marrë parasysh rëndësinë e kurseve të dështuara në synimet e përgjithshme të programit dhe në nivelin e kurset.
- Një certifikatë pasuniversitare mund t'i jepet një studenti që përfundon me sukses ose është kredituar të paktën 60 kredite britanike, nga të cilat 40 duhet të jenë në nivel M. Një diplome pasuniversitare mund t'i jepet një studenti i cili përfundon me sukses ose është kredituar të paktën 120 kredite, nga të cilat të paktën 90 duhet të jenë në nivelin M.

Bordi i Progresit dhe Diplomimit merr vendime në rast se studenti nuk e kalon një kurs, që mund të jetë rihënie të provimit (ose ridorëzim të detyrës së kursit) ose përsëritje të kursit në vitin e ardhshëm.

Studentët duhet të marrin si rezultat të të gjitha vlerësimeve 50% që kursi të jetë kalues. Studentët kanë të drejtë për tre përpjekje për të kaluar kursin. Studentët që mungojnë në provimin përfundimtar, kanë

mundësi të rijapin provimin vetëm nëse kanë një raport mjekësor. Ridhënia e provimit është kundrejt një pagesë prej 112 euro për secilën nga vlerësimet. Kjo tarifë është për të gjitha format e ri-vlerësimeve, provim përfundimtar apo detyrë kursi. Përsëritja e një kursi është 75% të tarifës së kursit. Studenti e përsërit tezën nëse nuk e përfundon në kohën e caktuar ose nuk e kalon, tarifa në këtë rast 50% të pagesës së tezës.

Bordi i Progresit dhe Diplomimit merr vendime për cdo rast problematik në ecurinë e studimeve të studentëve. Studentët nuk mund të mungojnë më shumë se 25% të orëve totale të klasës, në rast të kundërt do të përsërisin klasën. [dok "Dokumenti i programit"], [dok "Libri i Studentit"].

Tregues të matshëm:

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies paraqitet ne Tabelën 14, ne aneks.

Format e mësimdhënies janë të integruara, nuk janë të ndara në leksione, seminare dhe laboratore.

Format e kontrollit të njohurive paraqiten ne Tabelën 15 , në Aneks.

Format e kontrollit të njohurive përfshijnë provimin final (50-60%) dhe kontrollin e detyrës së kursit (40-50%), duke kontrolluar si njohuritë teorike ashtu dhe aftësitë praktike të studentit.

Sistemi i dhënies së vlerësimit:

Programi ndjek standardin e Universitetit te Greenwich per vleresimin e studenteve:

- Shkëlqyeshëm per notën: 70%+
- Shumë mirë për notën: 60%-69%
- Kalues për notën: 50-59%
- Ngelës për notën: 0-49%

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë ne Tabelën 16, në Aneks.

Për punime shkencore individuale të pedagogëve janë aktivizuar 6 studentë.

Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë është aktivizuar 1 student.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e programit të studimit MSc në Shkenca Komjuterike, GVJ konstatoi se UNYT ka procedura të qarta të pranimit të studentëve. Studentët duhet të zoterojnë së paku një diplomë Bachelor me 180 kredite ECTS, nga një institucion i akredituar për të aplikuar në këtë program studimi. Numri i studentëve të rregjistruar në 6 vitet e fundit janë 100 studentë nga të cilët dy janë transferuar. Regjistrimi bëhet sipas Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e

Shqipërisë", të ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi. Procedura e pranimit përfshin përveç dorëzimit të dokumenteve të kërkuara, edhe një intervistë me Drejtuesin e Programit. Në rast se aplikantët nuk kanë përvojë pune prej së paku dy vitesh dhe/ose nuk kanë diplomë bachelor në shkencë kompjuterike, u kërkohej të përfundojnë programin parapërgatitor të Masterit. Kriter është edhe dëshmia e gjuhës angleze (TOEFL IELTS ose ekuivalent në testet e tjera në gjuhën angleze). Nëse aplikanti nuk ka një dëshmi të anglishtes kërkohej të testohet në gjuhën angleze në UNYT dhe pastaj të bëjë intervistën. UNYT ofron për studentët kurse intensive të gjuhës angleze. Studentët me diplomë të dyfishtë kanë akses në informacionet e ofruara për studentët nga Universiteti i Greenwich-it si burimet e bibliotekës online [<http://www.gre.ac.uk>]

Në RVB është deklaruar se për të rritur cilësinë e studentëve në hyrje është kriter mesatarja 6,5 e studimeve Bachelor. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore në kontrollin random të dosjeve të studentëve rezultoi se nuk është marrë parasysh kriteri i mesatares. GVJ kërkoi shpjegim për të cilin mori përgjigjen se, në ato raste kur studenti nuk e përmbush kriterin e mesatares, ngrihet një komision brenda departamentit e cili e shqyrton rastin mbi bazën e kriterëve të notave të marra nga studenti në lëndët kryesore të degës në Bachelor dhe si dhe dega e ndjekur nga studenti në nivelin Bachelor. Në çdo rast, për çdo student që lejohet të hyjë në program, pavarësisht mesatares së tij, studenti duhet të kalojë provimet dhe detyrat e kursit të Programit Parapërgatitor në mënyrë që të vazhdojë më tej me lëndët e programit Master. Kjo procedurë mundëson seleksionimin edhe të atyre studentëve që hyjnë me mesatare të ulët se 6.5 dhe që aprovohen nga komisioni i ngritur.

Sekretaria mësimore dispononte një bazë të dhënash rezultatet e studentëve. Dosjet e studentëve ishin të plota me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Për studentët e rregjistruar në vitin akademik 2017-2018, sekretaria nuk kishte rregjistruar bazë edhe pse studentët janë pajisur me numër matrikullimi. Kishte një korespondencë të institucionit me QSHA për zgjidhjen e këtij problemi dhe GVJ kërkoi që ky dokumentacion të vihet në dispozicion [dok "Shkresat e dërguara nga QSHA në lidhje me Martikulimin dhe dhe regjistrat bazë të studentëve"]

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Studentët pranohen në bazë të nivelit të tyre në Anglisht dhe në bazë të mesatares në diplomën Bachelor. Niveli i kërkuar i gjuhës Angleze është B1 dhe nota mesatare për pranim është 6.5. [dok "Kriteret e pranimit"].

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Nga 100 studentë të rregjistruar për herë të parë në 6 vitet e fundit janë diplomuar 36 studentë. Referuar Tabeles 17 në Aneks mesatarja në dalje për katër vite (2012-2013, 2013-2014, 2015-2016, 2016-2017) është më e ulët krahasuar me mesataren në hyrje, ndërsa në vitet 2014-2015 dhe 2017-2018 është më e lartë.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë dhe Nota Mesatare janë paraqitur në Tabela 17 në aneks

Numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë, ka ardhur duke u zvogëluar nga 20 studentë në 2012-2013 në 9 studentë në 2017-2018.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Studentë të diplomuar në vitin e fundit janë 9 me mesatare 73.89%.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobilitet në kuptimin që studenti të kryejë studimet një semester diku në një Universitet dhe të kthehet nuk është realizuar asnjëherë.

Të dhëna për punësimin e studentëve, të paraqitura në Tabela 18 në aneks.

Gjatë 6 viteve të fundit janë punësuar 86 studentë, të gjithë brenda profesionit të tyre.

Numri total të diplomuarve pa përsëritje të viteve

36 studente të diplomuar

Numri total të diplomuarve

86 studente të diplomuar

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

86 studentë të punësuar

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

asnjë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimi dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimi.</p>	<p>Studentët pranohen në bazë të kriterëve të gjuhës angleze dhe të mesatares në diplomën Bachelor. Niveli i kërkuar i gjuhës angleze është B1 dhe nota mesatare për pranim është 6.5.</p> <p>[dok "Kriteret e pranimi"], [Takimi me studentët], [Vizita në sekretarinë mësimore]</p> <p>UNYT vlerëson herë pas here kriteret e pranimi dhe ndikimin e tyre në cilësinë e studentëve në programin e studimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>UNYT ka ngritur Zyrën e Karrierës e cila luan rolin e ndërmjetësuesit dhe mbajtjes së kontakteve ish-studentët, me komunitetet e biznesit në Shqipëri dhe rajon kanë si qëllim të ofrojnë praktike dhe mundësi punësimi për studentët dhe ish studentët e UNYT. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës. [Takimi me Zyrën e Karrierës], [dok "Lista e memorandumeve të bashkëpunimit"]</p> <p>Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve , për njohjen dhe vlefshmërinë, e diplomës së lëshuar nga UNYT; Studentët kanë mundësi për të fituar bursë bazuar në disa kritere të përzgjedhjes të cilat bëhen publike. [dok "Paketat e ndihmes ekonomike për programin MSc në Shkenca Kompjuterike"]</p> <p>[dok "Shpallja për Bursat e UNYT"]</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>UNYT përdor sistemin informative E-GNOMON për mbajtjen e të dhënave dhe ruajtjen e performancës së studentëve. Notat hidhen në këtë bazë të dhënash dhe mund të aksesohen nga studentët në mënyrë elektronike. Gjithashtu raporte të ndryshme mund të gjenerohen në çdo kohë për çdo periudhë studimi.</p> <p>[dok "Sistemi E-Gnomon"]</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>UNYT nëpërmjet Zyrës së Karrierës mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve. Zyra e Karrierës raporton në Senat me një raport vjetor.</p> <p>[Takimi me Zyrën e Karrierës].</p> <p>Kontaktet e Zyrës së Karrierës me komunitetet e biznesit në Shqipëri dhe në rajon, mundësojnë punësimin e studentëve dhe ish-studentëve të UNYT-it [dok "Shëmbull i memorandumeve të mirëkuptimit për intershipet"]</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë</p>	<p>Studentët e regjistruar prezantohen me programin e studimit përmes një ditë të hapur prezantimi, të organizuar me qëllim të paraqitjes së të gjithë</p>

<p>dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>informacioneve të nevojshme për studentët në lidhje me çdo aspekt të programit [dok “Prezantimi i Ditës së Orientimit”], [dok “DVD e shpërndarë tek studentët në ditën e orientimit”].</p> <p>Komisioni i Programit i përbërë stafi akademik dhe nga përfaqësuesit e studentëve takohet të paktën një herë në semestër për të diskutuar ecurinë dhe realizimin e programit. [dok “Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Programit”]</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>UNYT ofron mundësi të barabarta për studentët, pavarësisht racës, fesë, gjinisë, origjinës etnike, orientimit seksual, statusit personal dhe paaftësive fizike. Kampusi i UNYT-it është i pajisur me një ashensor për t’iu përshtatur nevojave të studenteve me aftësi të kufizuara motorike.</p> <p>Zyra e Karrierës ofron shërbime këshillimi për studentët në përgatitjen e tyre për tregun e punës [dok “Politikat e Zyrës së Karrierës dhe ish-Studenteve”]</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>UNYT ka procedura të qarta të pranimit të studentëve. Studentët janë të informuar në lidhje me programet e studimit dhe kriteret e pranimit në programin Master, si dhe në lidhje me akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve, me njohjen dhe vlefshmërinë, e diplomës së lëshuar nga UNYT. Studentët e regjistruar prezantohen me programin e studimit përmes një dite të hapur, të organizuar me qëllim paraqitjen e të gjithë informacioneve të nevojshme në lidhje me programin.</p> <p>UNYT ka ngritur Zyrën e Karrierës për të ndihmuar studentët gjatë studimeve të tyre, po ashtu pas studimeve në ofrimin e mundësive për punësim.</p> <p>UNYT ka sisteme informacioni për ruajtjen e të dhënave, performancës së studentëve dhe statistikave të studentëve gjatë edhe pas përfundimit të programit të studimit.</p> <p>Institucioni ka vendosur kritere për studentët e regjistruar në këtë program studimi, studentët duhet të kenë nivel të gjuhës Angleze së paku B1 dhe notë mesatare 6.5. Kriteri i mesatares nuk zbatohet në mënyrë të prerë, dhe në raste kur nuk plotësohet ky kriter, ngrihen komisione për të vlerësuar cilësinë e studentit dhe kapacitetin për të ndjekur programin papapërgatitor.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.




Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se aktiviteti i kërkimit shkencor zhvillohej në njesitë bazë, departamentet dhe në qëndren kërkimore. Drejtuesit e departamenteve dhe të Qendrës Kërkimore kontrollojnë dhe koordinojnë aktivitetet mësimore dhe kërkimore [dok “Statuti”]. UNYT ka qendrat kërkimore kryesisht përgjegjëse për aktivitetet kërkimore shkencore. GVJ konstatoi se anëtarët e departamentit ishin të përfshirë në punë kërkimore dhe anëtarët e qendres kërkimore ishin të përfshirë në mësimdhënie. Zyra e Financës përaktoi financimin e grupeve kërkimore apo aktiviteteve kërkimore sipas raporteve të qendrës kërkimore dhe të çdo departamenti [dok “Komunikimet rreth buxhetit me Fakultetet dhe Departamentet”]. Stafi akademik në këtë program studimi krahas mësimdhënies, zhvillon aktivitetet kërkimore shkencore dhe merr pjesë në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit si dhe bën publikime në fushën kërkimore të interesit. GVJ konstatoi se UNYT ka pjesëmarrje si partner në projektet e financuara nga programe të ndryshme evropiane [dok “Lista e memorandumëve të bashkëpunimit”]. UNYT ka akoma për të bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve dhe konkurrencën në aplikimet për fonde kërkimore ndërkombëtare me qëllim diversifikimin e burimeve apo të ardhurave dhe realizimit të prioriteteve të kërkimit institucional.

Tregues të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor Tabela 19 në Aneks

Nga te dhenat vihet re se stafi akademik ka 112 botime, 290 pjesëmarrje në aktivitete shkencore brenda institucionit dhe se ka përfshirë 27 studentë në kërkimin shkencor . UNYT ka 9 pjesëmarrje si partner në projektet e financuara nga programe të ndryshme, por ka akoma për të bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve dhe përpjekjeve në aplikimet për projekte brenda dhe jashtë vendit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit publikon artikuj në revista shkencore dhe merr pjesë me prezantime në konferenca brenda dhe jashtë vendit. Fushat e kërkimit shkencor të UNYT përcaktohen në bazë profilit të mësimdhënies ku rezultatet kërkimore integrohen në procesin e mësimimit. Që në 2012, kur UNYT u përcaktua si Universitet, qendrat kërkimore luajnë një rol të rëndësishëm në strategjitë e kërkimit shkencor dhe në aplikimet për grante nëpërmjet projekteve. [dok “Fushat e Kërkimit Shkencor”]</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit e zhvillon mësimin në anglisht. Stafi akademik miratohet nga Universiteti i Greenwichit me propozimin e UNYT. Kjo procedurë është në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit me UoG, që në vitin 2009 [dok “Mesazh për kërkesën e aprovimit të CV-ve.”]</p>

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësues-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

UNYT bën përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e cilësinë së mësimdhënies. Zyra e Sigurimit të Cilësisë, në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve, është përgjegjëse për çështjet e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. [dok "Manuali i Sigurimit të Cilësisë"] [dok "Workshop-e për zhvillimin e anetareve të Fakultetit"] [dok "Manuali i Lektorit"]

[dok "Dita e Orientimit për Lektorët e rinj"]

UNYT ka investuar në fondin e librave dhe burimeve audiovizive të bibliotekës.

Në mbështetje të mësimdhënies është krijimi i një Co-Labi që vepron si inkubator biznesesh. [dok "Co-Labi si inkubator për krijimin e bizneseve"]

UNYT bën përpjekje për rritjen dhe kualifikimin e stafit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, në funksion të kësaj janë organizimi dhe frekuentimi i seminareve të ndryshëm të trajnimit [dok "Liste aktivitetesh dhe seminaresh trajnimi"].

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

UNYT disponon informacionin e plotë të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi nëpërmjet raporteve vjetore në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e tjera.

UNYT përditëson listën e botimeve të stafit me botimet e fundit.

[dok "Outputi i kërkimeve shkencore të stafit të UNYT"]

Konkluzionet e vlerësimit:

Stafi akademik i programit të studimit publikon artikuj në revista shkencore dhe merr pjesë me prezantime në konferenca brenda dhe jashtë vendit. Fushat e kërkimit shkencor të UNYT përcaktohen në bazë profilit të mësimdhënies ku rezultatet kërkimore integrohen në procesin e mësimin.

UNYT disponon informacionin e plotë të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi nëpërmjet raporteve vjetore në lidhje me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet e tjera. Studentet përfshihen në aktivitetet shkencore.

UNYT ka pjesëmarrje si partner në projektet e financuara nga programe të ndryshme evropiane, por ka akoma për të bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve por ka akoma për të bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve dhe përpjekjeve në aplikimet për projekte brenda dhe jashtë vendit.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UNYT e ka pozicionuar veten që nga fillimi i saj si një IAL i orientuar ndërkombëtarisht [RVB fq 74]. Programi MSc në Shkenca Kompjuterike ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare e UNYT është ngritur në Shtator 2016.

Bazuar në RVB dhe dokumentacionin në dispozicion, GVJ konstatoi se UNYT ndjek një strategji të ndërkombëtarizimit të bashkëpunimit dhe partneriteteve në një nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar sipas shakallëve të mëposhtme:

- Ndërkombëtarizimi i kontigjentit studentor [dok “ Pika Strategjike 4.1”].
- Ndërkombëtarizimi i anëtarëve fakultetit [dok “ Pika Strategjike 4.2”].
- Krijimi dhe mbajtja e një rrjeti të partneriteteve ndërkombëtare [dok “ Pika Strategjike 6], shtrirë edhe në disiplina kërkimore dhe zhvillimore.
- Zhvillimi i programeve të shkëmbimit për studentët, personelin akademik dhe kerkuesit shkencorë [dok “ Pika Strategjike 4.3”].
- Politika e ndërkombëtarizimit [dok “ Politika e Bashkëpunimit dhe Ndërkombëtarizimit”].

Tregues të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar janë paraqitur në Tabelën 20, në Aneks. Janë 26 memorandume mirëkuptimi dhe bashkëpunimi

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë janë paraqitur në Tabelën 21, në Aneks. Rezultojnë 16 bashkëpunime nga komuniteti i biznesit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	UNYT ka bashkëpunim me aktorë të ndryshëm nga sektori i biznesit me qëllim që t’i ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar përvojat e tyre praktike në një mjedis pune. Lista e aktorëve përfshin kompanitë institutet, dhe institucionet publike [dok “Lista e Memorandumeve të Bashkëpunimit”].
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

UNYT nxit bashkëpunimin e stafit akademik nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, kërkimit shkencor të përbashkët, aktiviteteve të përbashkëta nga departamente të ndryshme.

Departamentet dhe qendra kërkimore, kanë përgjegjësi dhe detyra të qarta dhe të ndara, por janë të angazhuar të bashkëpunojnë për të ofruar rezultatet e kërkuara të punës së tyre.

[dok "Korespondencat mbi Inputit e Kerkuar nga Njësitë"]

[dok "Evidence per Korespondencen ndërmjet Njësive"]

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

UNYT e ofron këtë program në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich, Londër, UK, me synimin për të patur një profil ndërkombëtar për programin e studimit. Studentët kanë mundësinë të eksplorojnë edhe burimet dhe asetet shkencore të UoG-së gjatë periudhës së tyre të studimit në UNYT.

Përveç kësaj, UNYT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione jashtë vendit në mënyrë që të rrisë nderkombetarizimin e programeve të studimit.

[dok "Lista e Memorandumeve të Bashkëpunimit"]

Përveç kësaj, duhet të theksohet se Zyra për Karrierë dhe ish-Studente e UNYT, si dhe stafi drejtues i UNYT mbajnë lidhje të ngushta me Drejtorinë e Administratës Publike dhe me institucione të ndryshme kombëtare dhe organizata ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, me qëllim të lidhjes së të diplomuarve me tregun e punës.

[dok "Shëmbull i memorandumeve të mirëkuptimit për intershipet"]

Konkluzionet e vlerësimit:

UNYT ka marrëdhënie bashkëpunimi me universitete , organizata dhe biznese të ndryshme. Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare e UNYT garanton marrëdhënie të mira bashkëpunimi në nivel lokal dhe ndërkombëtar. UNYT ndjek Planin Strategjik 2017-2022, për ndërkombëtarizimin e studenteve, stafit akademik nëpërmjet programeve të ndryshme. UNYT e ofron këtë program studimi në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich, Londër, UK, me synimin për të patur një profil ndërkombëtar për programin e studimit.

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Për rekomandimin a) **Rekomandimi është përmbushur plotësisht.**

Për rekomandimin b), **Rekomandimi është përmbushur kryesisht**

Për rekomandimin c), **Rekomandimi është përmbushur plotësisht**

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

Pika të forta:

- a. Programi Master në Shkencat Kompjuterike ofrohet në bashkëpunim me Universitetin e Greenwich-it, Londër, dhe studentit i jepet mundësia e një diplome të dyfishte.
- b. Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi është i kualifikuar.
- c. Gjuha e mësimdhënies është gjuha angleze, në këtë mënyrë programi ka një profil ndërkombëtar.
- d. Infrastruktura në dispozicion të programit të studimit i plotëson të gjitha kushtet për ecurinë e programit të studimit.

Pika të Dobëta:

- a. Tarifa të larta të shkollimit për tregun lokal.
- b. Mungesa e formimit të mëparshëm bazë në fushën e informatikës të shumë studentëve para regjistrimit në program
- c. Mungesa e mjeteve për vlerësimin afatgjatë të efektivitetit të programit në treg
- d. Fonde të kufizuara për promovimin e kërkimit shkencor në programin Master
- e. Numer modest dhe paqëndrueshmëri i stafit akademik efektiv;

Mundësi:

- a. Mësimdhënia në gjuhën angleze inkurajon rekrutimin e studentëve ndërkombëtarë në program
- b. Reputacioni i diplomës britanike mund të tërheqë më shumë studentë.
- c. Rritja e kërkesës për specialistë të teknologjisë informatike në Shqipëri dhe në rajon mund të ndihmojë programin të rritet ndjeshëm në aspektin e numrit të studentëve.



